


MATERIAL

- Një copë pëlhurë (stof) pambuku që mund të lahet me temperatura të larta (të zihet) me përmasa 17 x 34 cm (tek meshkujt ndoshta edhe 17 x 36 cm, tek fëmijët 12 x 24)

Pëlhura duhet të mundësojë frymëmarrjen aktive! Kjo gjë duhet verifikuar paraprakisht. Merreni pëlhurën, paloseni dyfish dhe mbajeni para gojës dhe hundës. Nëse mund të merrni frymë lirisht, atëherë kjo pëlhurë mund të përdoret për qepjen e maskës.

- Dy rripa stofi me gjatësi 90 cm dhe gjerësi 2 cm
- Dy rripa stofi me gjatësi 17 cm dhe gjerësi 2 cm
- Një tel i hollë me gjatësi 15 cm (tel punëdore, pastrues llullash, tel metalik nga dosjet e holla për dokumente)



1. Paloseni dyfish stofin në mënyrë që të fitoni një katror me përmasat 17cm x 17cm.


Katër copat e gjata të stofit duhet t'i shënjoni dhe prisni në madhësitë e nevojshme.



2. Hekurosni stofin e palosur në formë katrori.



3. Bëni tri palë të njëtrajtshme në copën e palosur dyfish të stofit (thellësia e palëve 1,3 cm) dhe hekurosini palët.



Në këtë formë do të duhej të arrinit një lartësi prej 8,5-9 cm.



4. Katër rripat e hollë të stofit me gjerësi 2 cm hekurosini përgjysmë (shirita të gjatë).



5. Copën e pëlhurës (të stofit) vendoseni me pjesën e jashtme nga sipër në copën e stofit prej 17 cm (për përfor-cim të qosheve). Vëreni telin 15 cm të gjatë mes tyre dhe fiksojini të gjitha shtresat e stofit me njëra-tjetrën.




6. Hekurosni deri në gjysmë të katër shiritat e gjatë të stofit me gjerësi 2 cm (shirita të gjatë).



Atëherë e gjitha do të duhej të dukej kështu.



7. Palosni palat e hekurosurat të pëlhurës dhe vendosini nga të dy anët NË MES të shiritave të gjatë (shiritat për kokën) dhe fiksojini aty.



8. Hapi i fundit është qepja përgjatë dy shiritave të gjatë të stofit me qëllim që copa e fiksuar të jetë e qepur mirë nga të dy anët.





Maska është gati!

Ju dëshirojmë ta shijoni qepjen dhe të jeni shëndosh!

Ju bëjmë me dije që Klinika Leverkusen nuk mban përgjegjësinë për efektin, qepjen apo përdorimin adekuat të maskave ndihmëse të qepura vet për mbulimin e gojës dhe të hundës.

